




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VI/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 6 (gjashtë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.06.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
Z. Bashkim Ndrecaj
Z. Brahim Curri
Z. Alban Berisha
Z. Shefket Kolgeci
Z. Xhemajl Kabashaj
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Shqipe Ramaj
Z. Lirim Qatani
Z. Reshat Selimaj
Z. Ardian Kotorri
Z. Bexhet Kuçi
Z. Aziz Bytyqi
Z. Gazmend Gashi
Znj. Bardha Gashi
Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
Z. Jeton Rrakaqi
Z. Arbërim Basha
Z. Dardan Berisha
Znj. Marigona Gashi
Znj. Florie Bytyçi
Z. Sami Hajdari
Znj. Shkëndije Zenelaj
Z. Osman Selimaj
Z. Leonard Shala
Z. Dugagjin Palushi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Gëzim Kryeziu
Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë
Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të Ballkanit;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2022-2024;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës së sindikatës së administrates së Komunës;**
- 6. Shqyrtimi i raportit të komisionit për verifikimin e pronave ;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje.**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim.

Miratohet

Pika 2. . Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të Ballkanit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë,dhe hap debatin.

Jeton Rrakaqi - përshëndet të pranishmit.Është hera e dytë që vie një propozim i tillë pa konsultim me shefat e grupeve parlamentare.Të gjithë krenohemi me klubin e Ballkanin.Nuk jemi kundër ndihmës por jemi kundër vlerës 80 mijë euro.Kemi edhe shumë klube tjera që kanë pas sukses.Shumë më e arsyeshme është të ndihmohet sektori i shëndetësisë.

Dugagjin Palushi - përshëndet të pranishmit.Jam i të njetjtit mendim me Jetonin.Kisha thënë me i shpërnda këto mjete,maksimumi 30 mijë euro me iu nda Ballkanit.

Nexhat Ramadani - përshëndet të pranishmit.Detyra e qeverisë është që ti shqyrtoj këto kërkesa sipas mundësive.Të gjithë kemi dëshirë mi ndihmu Ballkanit,i cili ka bo lojra të mira.Ky propozim është i paanalizum dhe është ngarkesë për ne.Këtë propozim unë nuk e votoj. Kërkoj nga Kryetari dhe Kryesuesi pesë minuta pushim për një diskutim që ta bëjmë një ndarje edhe për kategoritë tjera,por që shumica të shkoj për Ballkanin.

Sami Hajdari - përshëndet të pranishmit.Po flas si një njeri që e përcjell sportin.Pse Ballkani nuk i shet aksionet? Ndoshta dikush nga ne mundet me ble dhe me ja dhan atë shumë që i duhet. Nuk mendoj që një klubi privat ti ndihmohet aq shumë dhe të anashkalohen klubet tjera .Unë nuk e votoj.Jo këtë, po as një shumë tjetër,vetëm nëse ndahen në proporcion.

Alban Berisha - përshëndet të pranishmit.A është në konsultë saktë me ligjin procedura e ndarjes së subvencioneve për një klub privat?

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor i përgjigjet pyetjes dhe jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim.

15 për, 12 kundër
Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Alban Berisha - kjo rregullore paska hy në fuqi në mars 2021.A ka pas naj konkurs deri sot? Nëse po ,pse nuk u zbatu ky akt nënligjor?

Remzi Bajselmani - përshëndet të pranishmit dhe jep përgjigje.

Alban Berisha - prej marsit a ka pas përzgjedhje të drejtorëve me konkurs?

Remzi Bajselmani - nuk ka pas.

Dardan Berisha - anëtarët e komisionit që janë propozu prej DKA-së,a kanë mandat katër vjeçar apo vetëm për një shpallje?

Remzi Bajselmani - ky komision do të jetë me një mandat,dhe çdo here formohet komisioni i ri.

Dugagjin Palushi - janë edhe dy anëtar që s'kanë të drejtë vote por kanë me qen aty,kush janë?

Remzi Bajselmani - janë dy anëtar,një nga këshilli i shkollës dhe një nga këshilli i prindërve.

Dardan Berisha – anëtarët, a i keni përcaktu ju?

Remzi Bajselmani - jep përgjigje.

Shefket Kolgeci - ministria a e cakton prej nivelit qëndror ,apo prej këtu?

Remzi Bajselmani - prej nivelit qëndror.

Bulëza Kuçi - pse su bo si ka hy n'fuqi ky akt,po tash?

Remzi Bajselmani - jep përgjigje.

Alban Berisha - pyetja ishte:pse se keni bo komisionin kur ju ka obligu udhëzimi administrativ prej muajit mars?

Remzi Bajselmani - ne kemi shku permes zyrës së personelit dhe është pjesë e tyre ti përgadisnin dokumentacionet dhe kohën e shpalljes.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime shtesë.

Alban Berisha - aktet nuk zbatohen prej qëndrimit politik, ato janë të obligueshme mu zbatu.

Kryesuesi - e hedh në votim.

19 për, 8 kundër
Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2022-2024;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Nexhat Ramadani - mendoj që edhe kjo kornizë afatmesme buxhetore është përpiluar në mënyrë jo profesionale, pa një debat të mirëfilltë publik me qytetarët për të marrë interesat dhe projektet që janë me interes për qytetarët. Ne kemi bashkëpunuar si opozitë dhe kemi dhënë kontributin tonë për miratimin e buxheteve, mirëpo nuk janë zbatuar projektet të cilat janë miratuar në Asamblë. Ne nuk do ta mbështesim sepse nuk i zbatoni vendimet e juaja dhe tonat.

Kryesuesi - Debatet publike janë mbajtur, dhe i falemnderoj 4 asamblëistët të cilët kanë marrë pjesë në debatet publike.

Nexhat Ramadani - nuk thashë që nuk janë mbajtur, por që nuk kanë qenë debate të mirëfillta.

Dugagjin Palushi - sa i përket kornizës, p.sh. në Budakovë është propozuar rruga „Kodra e thatë”, e cila është e kryer 100%, pastaj Buzhalë, „Bujar Buzhala” është e kryer. Kërkesë e fshatit është që të futen me një buxhet fshati Budakovë dhe Buzhalë, sepse Buzhala është lagje e Budakovës. Rugët e kryera hiqni nga buxheti. Kërkesë nga fshati Budakovë është që të gjitha këto projekte që janë parapa për Budakovë, unanimisht kryesia e fshatit kërkon të hiqen të gjitha dhe të mbetet vetëm projekti për furnizim me ujë dhe kanalizim.

Rilind Krasniqi - përshëndet të pranishmit. Një rrugë në fshatin Studenqan është shtruar në kohën e LDK-së, dhe tash është në kornizë, kërkoj sqarim. Ne si grup parlamentar nuk e votojmë këtë kornizë.

Ardian Kotorri - kam bërë një analizë për kornizën buxhetore dhe në bazë të pjesëmarrjes së disa debatëve publike, po shoh që disa prej kërkesave janë futur dhe është për tu vlerësuar. I mirëkuptoj vërejtjet dhe kritikën e partive politike, por të Nexhatit jo aq shumë.

Nexhat Ramadani - Jemi bindur që nuk mund të miratojmë diçka kur nuk respektohet. Kam shqetësime për rrugët që janë të shtruna, të cilat i keni qitë prap, dhe keni qitë rrugë dhe s’janë shtruar. P.sh. në Leshan rr. „Mbreti Spirro”, unë nuk di që është kjo rrugë. Është rr. Mbreti Pirro dhe është e kryer.

Reshat Selimaj - përshëndet të pranishmit. Në debat publik ka qenë kërkesë e qytetarëve dhe kryesisht zgjerimi i urës, sepse ka shumë aksidente.

Laureta Tafaj - i bashkangjitem kërkesë së Reshatit për ato dy ura.

Jeton Rrakaqi - debatet publike nuk kanë qenë të mirëfillta, duke filluar nga fshati im, veç pakënaqësi ka pas. Në Gelancë rruga „Qershia”, janë tre anekse, duhet të dimë cila, pastaj ndërtimi i kanalizimit në Gelancë, nuk di ku është rruga, pastaj ndërtimi i rrugëve „Kodra Nuha”, një rrugë është dhe është në fazën e fundit. Rruga „Fisnikët”, ku është?

Enver Shabani - rruga „Fisnikët” është kërkesë e komunitetit rom-ashkalij.

Jeton Rrakaqi - investimet në rrugën fushore dhe zgjerimi i lumenjëve janë të nevojshme, por forma e punës si po bëhen, janë manipulative. Grupi parlamentar i PDK-së është kundër.

Leonard Shala - mendoj që ndërtimi dhe rregullimi i varrezave është projekt i domosdoshëm, ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu gjithëashtu është prioritet, kurse ndërtimi i rrugëve lokale, segmenti i rr. Skënderbeu dhe rrugë të tjera, mendoj që para se të votohet duhet të mbajmë disa takime për mu specifikisht më qartë.

Kryetari - përshëndet të pranishmit. Falemnderon asamblëistët për bashkëpunimin. Unë pajtohem me Nexhatin i cili ka udhëhequr shërbimet publike dhe i din procedurat. Lexoni procesverbalet, kërkesat e qytetarëve. Qka kanë kërkuar, ato janë. Jemi mundë të japim ditë përpara në çdo fshat me shkuar dhe me i njoftuar. Nuk jemi të përkryer. Kemi kryer punën aq sa kemi ditë dhe aq sa kemi mujt. E di që nuk kalon, por është në të mirë të qytetarëve.

Nexhat Ramadani - Kryetar, falemnderit për fjalë të mira, por ne e dhamë qëndrimin tonë. Ju duhet të kërkonit falje sepse me veprimet tua e ke humb besimin.

Kryetari - falemnderon për këshillat.

Jeton Rrakaqi - ndihem krenar që jam në grupin parlamentar të PDK-së si shef i grupit, ku as një vendim nuk ka ndodh me qenë një votë jasht grupit parlamentar. Ju Kryetar jeni tu bo politikë të pandershme.

Bashkim Ndrecaj - përshëndet të pranishmit. Unë kam marrë pjesë në të gjitha debatet publike. Ne si kryesi e fshatit kemi mbajtur takim para debatit publik dhe jemi dakordur për renditjen e prioriteteve tona si fshat, mirëpo këtu dalin ndryshe. Përmirësoni këto.

Elmaze Bytyqi - kërkoj që të futen në prioritet rregullimi i kanalizimit për dy lagjet e reja: Bajram Hajdari dhe Shefket Bytyqi, poashtu edhe dy lagje në rrugën Kalaja, dhe rregullimi i dy rrugëve kryesore: Sahit Hajdari dhe Blerim Rraka.

Shefket Kolgeci - për vitin 2021 e kanë futur një rrugë. Nuk është prioritet, më prioritet është kanalizimi.

Xhemajl Kabashi - përshëndet të pranishmit. Nëse përmirësohet dhe merren parasysh kërkesat, shohim e bëjmë. Në fshatin Krushicë prioritet kanë qenë kanalizimet dhe nuk i keni bo. Unë nuk i pashë këto, e Kryetari na ka premtu.

Kryetari - i jep përgjigje para folësit.

Kryesuesi - kemi kërkesë për zgjerimin e urës në Grejkoc, pastaj kemi kërkesë nga asambleistja e LDK-së që në dy lagjet të futet si prioritet kanalizimi dhe rregullimi i dy rrugëve Sahit Hajdari dhe Blerim Rraka. Gjithëashtu është edhe kërkesa e asamblistit Shefket Kolgeci që të hiqet rruga e planifikuar dhe të futet kanalizimi.

Kryesuesi - me këto ndryshime e hedh në votim.

**11 për, 15 kundër
Nuk Miratohet**

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesës së sindikatës së administratës së Komunës;

Kryesuesi - lexon kërkesën e administratës. Ne e kemi përpiluar një vendim së bashku me antarët e ekzekutivit dhe e kemi caktuar shumën për shujtje prej dy euro në ditë. Hap debatin.

Alban Berisha - kjo kërkesë është shumë e mirëseardhur, mirëpo pse ka nevojë arsimtarët me shku përmes avokatit mi marrë paratë që i takojnë me ligj ?

Avni Bytyqi - kontratës së përgjithshme kolektive i ka skadur afati, dhe për këtë arsye ne duhet të marrim vendim në Kuvend për ta realizuar, e cila ka bazë ligjore. Ndërsa për kontratën kolektive të arsimit, ajo kontratë kolektive është e ripërtirë nga sindikata e arsimit dhe ministria e arsimit dhe nuk ka nevojë të vije në Kuvend.

Alban Berisha - pse s'po zbatohet nga Komuna ?

Kryetari - nuk është në kompetencë të Komunës. Atë marrëveshje e ka bo qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit.

Alban Berisha - nëse je palë dhe e fiton lëndën me përmbartues, ato mjete a merren prej qeverisë apo prej Komunës ?

Kryetari - ajo është qështje e gjykatës.

Dardan Berisha - kjo kërkesë e sindikatës nuk po përputhet me atë që thonë ju. Pse për vitin 2022 dhe pse 2 euro, dhe jo sipas kërkesës nga 2.50 euro. Ne jemi në proces gjyqësor por kjo kërkesë duhet të realizohet.

Kryesuesi - lexon dhe një herë kërkesën.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime shtesë.

Leonard Shala - ligji i pagave ka mbet pa u miratu.Unë jam pro,por ka shumë që e meritojnë dhe shumë që nuk din as çfarë pune bëjnë.Është mirë me na sjellë CV-të e administratës.

Florie Bytyqi - ne jemi pro kërkesës për 2.50 euro.Me dy euro është nënqimim.Ne kemi kërku edhe mandatin e kalum për ngritjen e poentimit për zyrtarë.

Laureta Tafa - edhe unë si kolegët jam për 2.50 euro.Pse mos me fillu mu zbatu prej tash,po prej janarit ?

Nexhat Ramadani - edhe ne si grup parlamentar e mbështesim shumë prej 2.50 euro,dhe të hyjë në fuqi menjëherë si të merret vendimi.

Jeton Rrakqi – në emër të grupit parlamentar kërkojmë që të caktohet vlera 2.50 euro dhe të filloj prej muajit korrikë.

Kryesuesi - mbas kërkesës së delegatëve shujta të jetë 2.50 euro dhe të filloj prej muajit korrikë. E hedh në votim.

Me 1 apstenim Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i raportit të komisionit për verifikimin e pronave ;

Kryesuesi - është formu komisioni për verifikimin e pronave nga Asambleja dhe ftoj kryesuesin e këtij komisioni rreth sqarimit të raportit.

Xhemjl Kabashi - përshëndet të pranishmit.Ky komision është i përbërë prej nëntë antarëve,dhe ka mbajt gjithsej 13 takime.Gjatë takimeve ky komision ka analizu rreth 1804 prona Komunale. Të gjitha këto të dhëna(të gjeturat,rekomandimet)i keni të gjitha në raport.Mendoj që është një raport ose një bazë e mirë për ekzekutivin. Propozimi i komisionit ka qenë që ,një zyrtari komunal ti caktohet përshkrimi me këto detyra të punës.

Laureta Tafaj - kam kërkesë që këtë raport me publiku në faqe të Komunës.

Leonard Shala - unë si inicues falemderoj kryesuesin dhe antarët e këtij komisioni.Të gjeturat janë këto që tha kryesuesi.Komisioni sugjeron lirim të pronave që janë pa kontratë. Më shumë se 450 prona komunale kanë ndërtim pjesërisht.Mirëpo kemi zyrtar në drejtorinë e pronës që përshkrimin e vendit të punës e ka për këtë punë.

Dardan Berisha - a do ta vazhdoni ju në bazë të kompetencave tuaja punën apo do ta ndërpreni këtu ?

Kryesuesi - nuk kam përgjigje.

Jeton Rrakqi - si antar i komisionit jam tmerru.Përgjigjësia është e dy subjekteve politike. 20 vjet mos mu kanë në gjendje mi menagju pronat e Komunës !

Dugagjin Palushi - pronat e Komunës shfrytëzohen jashtëzakonisht në mënyrë të egër.Borgji total është afër 300 mijë euro.Rekomandimet që i kemi dhënë si komision,ju kisha lut me i përcjell te ata persona dhe me marr diçka në këtë drejtim.

Pika 7. Pyetje dhe përgjigje.

Xhemajl Kabashi – përpos këtij komisioni kam qenë edhe anëtar me mandat katër vjeçar,komisioni për dhënien e pronës publike.Diçka që kam has mbas mandatit,del që disa familjar na kanë marrë prona ,që me dokumente janë në rregull,mirëpo neve na kanë qit në lajthitje duke konkuru në emër të bashkëshortes,bashkëshortit,dhe mbas disa bisedave me qytetarë del që ata janë antar të AAK-së.

Avni Bytyqi - me një proces të konkurimit kanë marrë pjesë ?

Xhemajl Kabashi - jo ,ndamas.

Avni Bytyqi - ska asgjë të keqe.

Kryetari - janë qytetarë dhe të gjithë janë të barabartë,është ligji.

Alban Berisha - dalja në shesh nuk është e sigurt dhe kish qenë mirë me shku me dy variante.Varianti i parë është me mbyll prej orës 8 në mbrëmje deri në 24 prej urës së madhe deri te Benafi,dhe varianti i dytë,nese nuk ka mundësi mu mbyll,ju si kryesues për KKSB me mbajt një takim urgjent me policinë dhe me pas policë sa ma shumë.

Kryetari - unë pajtohem me ty,por nuk është e lehtë me bo unazë.Bëjmë diskutime publike dhe vendosin qytetarët e Suharekës.Këtë punë për monitorim e ka policia.

Alban Berisha - nese destinimi i sheshit është për shetitore për qytetarët, për momentin nuk i plotëson kushtet,është një trotuar i zgjeruar.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit.Pse departamenti i rentgenit nuk kryen disa radiografi ? Pse nuk funksionon aparati për rendgen të dhëmbëve ? Aparati për zbardhimin e dhëmbëve është dhe pse nuk funksionon ?

Besa Kuçi - përshëndet të pranishmit.Nuk jam në dijeni që është një aparat për zbardhimin e dhëmbëve,ndërsa për aparatin e rentgenit të dhëmbëve u bë një keqklasifikim për shkak se nuk është planifiku mu ble edhe zhvilluesi i filmave.Ne në planifikim e kem fut në procedurë të prokurimit.

Shefket Kolgeci - për një zhvillues e keni lënë aparatin për tre vjet.Aparati i zabrdhimit të dhëmbëve është luks.

Besa Kuçi - jep përgjigje.

Shefket Kolgeci - qështja e kanalizimit filloi në 2017 dhe ende nuk po kryhet.Ku është problemi që u ndërpre ?

Enver Shabani - përshëndet të pranishmit.Kanalizimi në Vraniq ka fillu në fund të 2020 - ës.

Shefket Kolgeci - projekti i kanalizimit ka fillu më 2017 dhe qëllimi është me kry.

Enver Shabani - kontrata është e hapur dhe është brenda afatit ligjor.Punëkryesi ka premtu që do ta kryej dhe puna fillon pasnesër.

Jeton Rrakaqi - dje e kemi pa një video me një portal,a është e vërtetë apo montazh ?

Cila qëndron e vërteta që dalin emrat për mu pranë në punë nëper portale dhe të njejtit pranohen ?

Besa Kuçi - jep përgjigje.

Bashkim Ndrecaj - rrugët Pashko Vasa dhe Faik Konica në Shirokë,kur do të fillojnë ,dhe kur do ta rregulloni urën në Shirokë për ujrat atmosferike ?

Kryetari – jep përgjigje.

Takimi përfundi: 12 : 25

Procesmbajtësja :

Dafina Haziraj